



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2224/6 Prot.

Durrës, më 15.11.2024

VENDIM

Nr. 58, datë 15.11 2024

PËR

**"PËR MIRATIMIN E TARIFËS PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL NË "OFICER SIGURIE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE", NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr.1, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik nr.27, datë 06.11.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së programit të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në "Oficer Sigurie në Institucionet Arsimore", në Fakultetin e Edukimit.
2. Programi i studimit do të realizohet pranë Qendrës së Edukimit në Vazhdim.
3. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 1000 lekë/kredit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standardeve të Cilësisë
5. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

